



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Ujërat, si trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistimore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës në këtë përbërje:

1.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës,	Kryesues;
1.2. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	anëtar;
1.3. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal,	anëtar;
1.4. Ministri i Financave,	anëtar dhe
1.5. Ministri i Zhvillimit Ekonomik,	anëtar.
2. Këshilli Ndërmintor për Ujëra jep mendime dhe rekomandime për:
 - 2.1. propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
 - 2.2. zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
 - 2.3. hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për ujëra;
 - 2.4. zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;
 - 2.5. zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.
3. Këshilli Ndërmintor për Ujëra kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.
4. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote janë edhe Përfaqësuesi i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim (si koordinator të sektorit të ujërave në komunitetin e donatorëve) dhe përfaqësues (me rotacion) të donatorëve aktiv në sektorin e ujërave.
5. Këshilli Ndërmintor për Ujërat do të ketë Sekretariatin e tij, i cili do të ndihmojë në kryerjen e punëve dhe obligimeve të Këshillit. Sekretariati do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe do të përkrahet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.

6. Sekretariati do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Rregulloren e punës të miratuar nga Qeveria.
7. Mjetet për shpenzimet e punës së këshillit ndërministror të ujërave sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.
8. Këshilli ndërministror i ujërave përgatitë raporte vjetore të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.
9. Obligohen të gjitha Ministritë e linjës ta ndihmojnë dhe përkrahin Këshillin dhe Sekretariatit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiave.
10. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 04/149 i datës 19 shtator 2013.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Rrugës Nacionale N2, Prishtinë-Mitrovicë, Segmenti Milloshevë-Vushtrri, Zonat Kadastrale Babimoc dhe Milloshevë, Komuna Obiliq, Zonat Kadastrale Stanovc i Epërm (Përronaj) dhe Lumi i Madh, Komuna Vushtrri, Rrugës Nacionale N9 Prishtinë-Pejë, Zonat Kadastrale Sllatinë e Madhe dhe Harilaq, Komuna Fushë Kosovë, Zona Kadastrale Koreticë e Epërme, Komuna Drenas dhe Rrugës "Transiti i Shtimes", Zona Kadastrale Shtime, Komuna Shtime, sipas tabelave bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/18


Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 17/2012 për caktimin e lartësisë së pagesës së shërbimeve dhe kontrolleve zyrtare të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.
2. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 62.4 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-165, nr. 04/L-194 dhe nenit 4 të Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për miratimin e buxhetit për Komunën e Prishtinës pas ri-aprovimit të Buxhetit për vitin 2015 nga Kuvendi Komunal Prishtinë me datë 24 shkurt 2015.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me tabelat t'ia procedoj Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeveris



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Kompensimin e Viktimave të Krimit.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit, që shpie në Terrorizëm 2015-2020

1. Grupi Punues Qeveritar për hartimin e Strategjisë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit, që shpie në Terrorizëm 2015-2020, ka këtë përbërje:

1.1.	Këshilltari i Kryeministrit,	Udhëheqës i Grupit;
1.2.	Përfaqësuesi nga MPB,	Bashkë-Koordinator;
1.3.	Zyra për Planifikim Strategjik ZKM,	Bashkë-Koordinator;
1.4.	Përfaqësuesi nga MKRS,	anëtar;
1.5.	Përfaqësuesi nga MPMS,	anëtar;
1.6.	Përfaqësuesi nga MASHT,	anëtar;
1.7.	Përfaqësuesi nga MPJ,	anëtar;
1.8.	Përfaqësuesi nga MIE,	anëtar;
1.9.	Përfaqësuesi nga AKI,	anëtar;
1.10.	Përfaqësuesi nga (PK),	anëtar;
1.11.	Përfaqësuesi nga MAPL,	anëtar;
1.12.	Përfaqësuesi nga MF,	anëtar;
1.13.	Sekretariati i Këshillit për Siguri ZKM,	anëtar;
1.14.	Përfaqësuesi nga Zyrës së Presidentit,	anëtar;
1.15.	Komisioni i Pavarur për Medie,	anëtar;
1.16.	Përfaqësuesit e Bashkësive Fetare,	anëtar;
1.17.	Përfaqësuesit e OJQ-ve relevante,	anëtar dhe
1.18.	Përfaqësuesi nga Kuvendi i Kosovës,	anëtar.

2. Në cilësinë e vëzhgueseve dhe ekspertëve do të ftohen: Përfaqësues Ndërkombëtar: Ambasada e SHBA-së, UNDP-së, OSBE-së, ICITAP, EULEX, Zyra e BE-së në Kosovë, Ambasadat tjera sipas interesimit të tyre dhe ekspert tjerë vendor dhe ndërkombëtarë.
3. Sipas nevojës dhe në bazë të vlerësimeve të Udhëheqësit dhe Grupit Punues anëtar tjerë mundë t'i shtohen Grupit Punues.

4. Grupi Punues ka për detyrë të hartojë Strategjinë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që shpie në Terrorizëm për vitet 2015-2020.
5. Obligohen të gjitha ministritë dhe institucionet tjera t'i kryejnë obligimet e parapara me këtë Vendim, të bashkëpunojnë me Grupin Punues dhe t'iu përgjigjen kërkesave të grupit punues.
6. Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit ofron shërbimet e nevojshme të sekretarisë për mbarëvajtjen e punës së grupit punues.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I rekomandohet Presidentes së Republikës së Kosovës që në detyrën e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës të emëroj Gjeneralmajor z. Rrahman Rama.
2. Emërimi i Komandantit të FSK-së do të bëhet nga data 15 mars 2015 dhe do të jetë i plotfuqishëm deri në marrjen e një vendimi tjetër.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm e Zyrës së Kryeministrit për përcjelljen e këtij vendimi për dekretim nga Presidentja e Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-082.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/18
Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për hartimin e draftit të Kodit Civil (në tekstin e mëtejme: Komisioni)
2. Për anëtarë të Komisionit, emërohen:
 - 2.1. Prof. Dr. Hajredin Kuçi, Ministër i Drejtësisë, Kryesues;
 - 2.2. Dr. Sc. Bedri Bahtiri, Zv. Kryesues;
 - 2.3. Prof. Dr. Abdulla Aliu, Anëtar;
 - 2.4. Prof. Dr. Faik Brestovci, Anëtar;
 - 2.5. Prof. Dr. Iset Morina, Anëtar;
 - 2.6. Prof. Dr. Nerxhivane Dauti, Anëtare;
 - 2.7. Prof. Dr. Asllan Bilalli, Anëtar;
 - 2.8. Prof. Dr. Hamdi Podvorica, Anëtar;
 - 2.9. Prof. Dr. Haxhi Gashi, Anëtar;
 - 2.10. Prof. Dr. Robert Muharremi, Anëtar;
 - 2.11. Prof. Dr. Rustem Qehaja, Anëtar;
 - 2.12. Sefadin Blakaj, Anëtar;
 - 2.13. Rexhep Haxhimusa, Anëtar;
 - 2.14. Erdogan Haxhibeqiri, Anëtar;
 - 2.15. Ymer Hoxha, Anëtar;
 - 2.16. Muhamet Rexha, Anëtar;
 - 2.17. Muharrem Shala, Anëtar;
 - 2.18. Ilaz Ramajli, Anëtar;
 - 2.19. Ferid Gjikolli, Anëtar;
 - 2.20. Lazim Salihu, Anëtar;
 - 2.21. Adem Vokshi, Anëtar;
 - 2.22. Qazim Qerimi, Anëtar;
 - 2.23. Virtyt Ibrahimaga, Anëtar;
 - 2.24. Ruzhdi Berisha, Anëtar dhe
 - 2.25. Lulzim Aliaj, Anëtar.
3. Për sekretar të Komisionit emërohet Lulzim Aliaj.

4. Komisioni themelohet me qëllim të kodifikimit të së drejtës civile dhe hartimit të draftit të Kodit Civil.
5. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme apo të përhershme si dhe mund të angazhojë ekspert nga fusha e të drejtës civile.
6. Në punën e tij, Komisioni mund të shfrytëzojë mbështetjen profesionale të organizatave dhe institucioneve përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
7. Komisioni mund të nxjerr rregulloren për punën e tij.
8. Komisioni është i obliguar që për punën e tij, çdo gjashtë muaj t'i raportojë Qeverisë.
9. Komisioni është i obliguar që Ministrisë së Drejtësisë t'ia dërgojë tekstin e draft Kodit Civil në afat prej 24 muaj nga dita e nënshkrimit të këtij Vendimi.
10. Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë mjete financiare Ministrisë së Drejtësisë për punën e Komisionit.
11. Lartësia e kompensimit për punën e anëtarëve të Komisionit dhe të sekretarit të Komisionit do të caktohet me vendim të Ministrit të Drejtësisë.
12. Ministria e Drejtësisë obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e Komisionit.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë